ALBCONTROL
Nr. 422 Prot.
Datë,më 2. 2 .202

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

MINISTRI

Nr. 1022 Prot. Tiranë, më 28/1 /2026

Lënda: Mbi Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2026

ENTIT PUBLIK "ALBCONTROL"

Rinas

Në vijim të shkresës tuaj nr.36prot., datë 22.12.2025, me të cilën është përcjellë Programi i Zhvillimit Ekonomik për vitin 2026, pas shqyrtimit të treguesve ekonomikë të parashikuar në program, nga pikëpamja e politikave këto tregues janë orientuar në funksion të përmbushjes së përgjegjësive dhe objektivit të punës së Ofruesit të Shërbimeve të Lundrimit Ajror, të përcaktuara në ligjin 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar), ligjin 40/2024 "Për Ofruesin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror Albcontrol", si dhe në funksion të rritjes së përformancës në ofrimin e shërbimeve në përputhje me rekomandimet dhe standartet e vendosura nga organizmat ndërkombëtarë.

Për sa më sipër, në zbatim të pikës 6 të udhëzimit të MFE nr.15, datë 15.02.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", shprehemi parimisht dakord me treguesit e parashikuar në program nga "Albcontrol", të miratuar me vendimin nr.08, datë 18.12.2025 të Këshillit Drejtues, duke nënvizuar faktin për një rishikim të mundshëm të programit, me qëllim reflektimin e transfertës kapitale të kryer, mbështetur në Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025" (të ndryshuar).

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR

Belinda Balluku